FLETUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

MELIODINE

Ovula – 200 mg
(Povidonjod)

Lexojeni me kujdes këtë fletudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletudhëzues:

1. Çfarë janë ovulat Meliodine dhe përse përdoren
2. Përpara se të përdorni ovulat Meliodine
3. Si t'i përdorni ovulat Meliodine
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si t'i ruani ovulat Meliodine
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË JANË OVULAT MELIODINE DHE PËRSE PËRDOREN

Ovulat Meliodine përmbajnë lëndën aktive povidonjod. Povidonjodi është një kompleks i jodit me povidonin (polivinilpirolidon), ndërsa povidoni është polimer sintetik hidrofil që luan rolin e bartësit të jodit. Ky polimer nuk ushtron veprim antibakteror, por ka afri të lartë për membranën qelizore, ndërsa në trajtë kompleksi me jodin, pra në trajtë të povidonjodit, çliron jod të lirë drejtpërdrejt në sipërfaqen e qelizës bakterore. Çlirimi i jodit nga kompleksi povidonjod në membranën bakterore ka rëndësi thelbësore për veprimin e jodit. Në prani të jodit të lirë grupet sulfhidrile, peptidet, proteinat, hormonet, enzimat, lipidet dhe citozina bëhen të joduara apo halogjenuara dhe të oksiduara, çka sjell çaktivimin e molekulave të domosdoshme për përtëritjen e organizmit. Povidonjodi që ndodhet në ovulat 200 mg veprongjithashtu edhe në praninë e lëndëve organike, gjakut, qelbit, serumit dhe të yndyrës.

Meliodine indikohet për:
- mjekimin e vaginitit të shkaktuar nga Trichomonas vaginalis dhe Monilia albicans;
- mjekimin e vaginitit të përzier.

2. PËRPARA SE TË PËRDORNI OVULAT MELIODINE

Mos përdorni ovulat Meliodine në qoftë se keni:
- mbindjeshmëri të njohur ndaj jodit, ndonëse personat e ndjeshëm, normalisht nuk reagojnë ndaj povidonjodit, ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të ovulave Meliodine;
- sëmundje të gjendrës tiroide;
- dermatit herpetiform të Duhring.

Shmangni përdorimin e rregullt ose të zgjatur të Meliodine nëse jeni duke u trajtuar me litium.
Mos përdorni përgatesa që përmbajnë jod dhe povidonjod para dhe pas radioterapisë (deri në fund të trajtimit).

Tregoni kujdes të veçantë me Meliodine
- kur keni çrregullime të funksionit të tiroides;
- kur keni dëmtime të funksionit të veshkave;
- kur konceptimi është i dëshirueshëm sepse povidonjodi është spermicid.

Evitoni përdorimin e rregullt apo të zgjatur sepse mund të çojë në përthithjen e tepruar të jodit, rrjedhimisht në serum mund të gjendet një sasi e konsiderueshme jodi, si dhe jodi të lidhur me proteinat plazmatike.
Nëse ovulat shkaktojnë acarim, edemë apo ndonjë lloj tjetër reaksioni, ndërpritni trajtimin.
Ovulat Meliodine janë vetëm për përdorim vaginal dhe **nuk duhet të gëlltiten.**

Marrja e barnave të tjera
Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga ovulat Meliodine.
Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë / përdorur ose keni marrë / përdorur kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Meliodine në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit.
Është veçanërisht e rëndësishme që mjeku juaj të jetë në dijeni të faktit që ju jeni duke u trajtuar me barna të tjera.
- Përdorimi në të njëjtën kohë edhe i sulfadiazinës argjendike, ose i klorheksidinës mund të shkaktojë çaktivim.
- Jodi i përthithur përmes lëkurës së padëmtuar ose të dëmtuar si edhe përmes mukozave mund të interferojë në provat për funksionin e gjendrës tiroide.
- Nuk rekomandohet përdorimi në të njëjtën kohë i povidonjodit dhe i tretësirave dezinfektuese që përmbajnë kripëra të mërkurit, përbërje të benzoinës, antiseptikë që përmbajnë oktenidinëapo lloje të tjerë dezinfektuesish dhe detergjentësh.

Shtatzënia dhe ushqyerja me gji
Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut përpara se të përdorni këtë bar në periudhën e shtatzënisë ose të ushqyerjes me gji. Ovulat Meliodine duhen evituar gjatë periudhës së shtatzënisë dhe ushqyerjes me gji.
Në rastet kur është absolutisht e nevojshme, duhet përdorur me kujdes, vetëm nën përshkrimin dhe kontrollin e mjekut.

3. SI T'I PËRDORNI OVULAT MELIODINE

Ovulat janë vetëm për përdorim vaginal.
1 ovulë në ditë, (zakonisht në darkë, para gjumit). Është e këshillueshme të vendosni ovulën në vaginë dhe të qëndroni në pozicion shtrirë për disa minuta.

Në qoftë se keni përdorur më shumë Meliodine
Në qoftë se keni përdorur më shumë Meliodine se sasia që duhej të përdornit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni me mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.
Mund të shfaqet hipertiroidizëm ose hipotiroidizëm nëse tejkalohet doza e rekomanduar.
Ovulat nuk duhet të gëlltiten. Gëlltitja e disa dezinfektuesve mund të ketë pasoja serioze, ndonjëherë fatale.

Në qoftë se harroni të përdorni Meliodine
Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), përdoreni në vazhdim kur të jetë koha për përdorimin e zakonshëm të saj.
Mos përdorni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij bari, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, ovulat Meliodine mund të shkaktojnë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston.
Ndonjëherë ato janë serioze, ndonjëherë jo. Mos u alarmoni nga kjo listë e efekteve të mundshme anësore. Mund të mos ju shfaqet asnjë prej tyre.
Efektet e padëshirueshme më të shpeshta janë:
- reaksione mbindjeshmërie që shfaqen me irritim të lëkurës dhe të membranave mukoze, me skuqje dhe kruarje në vendin e përdorimit;
- reaksion anafilaktik pas përdorimit vaginal të tretësirës së povidonjodit.

Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletudhëzues, lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI T'I RUANI OVULAT MELIODINE

Mbajini larg fëmijëve!
Mos i përdorni ovulat Meliodine pas datës së skadimit, e cila është e shënuar në paketim.
Mos i ruani mbi 25°C.
Ruajini në paketimin origjinal për t'i mbrojtur nga drita.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmbajnë ovulatMeliodine
Lënda aktive është povidonjod.
1 ovulë vaginale përmban 200 mg povidonjod.
Lëndët ndihmëse janëmakrogol 400 dhe makrogol 1500.

Përmbajtja e paketimit
Kuti kartoni me 14 ovula.

Mbajtësi i Autorizimit të Tregtimit dhe Prodhuesi:

PROFARMA sh.a.,
Rruga "Skënder Vila",
Tiranë, Shqipëri.
Tel.: +355 4 23 89 602

Ky fletudhëzues u rishikua për herë të fundit në Tetor 2023.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible. If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.